



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-149813/25 me dt. 01 OCT 2025

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, neni 7 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve me nr.01-011/01-79067/25, dt.04.06.2025, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi për themelimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për mbështetje financiare për Familjet Strehuese dhe Fëmijët në Strehim Familjar.
- II. Sipas pikës 1 të këtij vendimi , anëtarët të komisionit janë :
 1. Premtim Fazliu, Drejtoria e Mirëqenies Sociale, Kryesues;
 2. Emi Zeqiri , Qendra Për Punë Sociale, anëtare;
 3. Besarta Morina, Drejtoria e Mirëqenies Sociale, anëtare;
 4. Qëndrim Lluka, Shoqëria Civile, ekspert të jashtëm, anëtar ;
 5. Petrit Sopjani, Shoqëria Civile ,ekspert të jashtëm, anëtar .
- III. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, anëtar rezervë caktohen, Arjeta Gashi nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Lulzim Beqiri, Shoqëria Civile dhe ekspert të jashtëm.
- IV. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjarë të cilat iniciohen nga menaxherët e rasteve të Qendrës për Punë Sociale të Kryeqytetit, duke u bazuar në Vendimin me nr.01-/03-45628/25, dt.02.02.2025, si dhe Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës nr.01.-011/01-79067/25, të datës 04.06.2025
- V. Për kryerjen e detyrave si në pikën IV të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
- VI. Komisioni si në piken II të këtij vendimi ka mandat njëvjeçar me mundësi të vazhdimit.
- VII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me nr.14-020/04-77064/25 i dt.02.06.2025.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U DORËZOHET :

- Anëtarëve të Komisionit ,
- Qendrës për shërbim me qytetarë,
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

